

VENDIM
Nr. 705, datë 26.11.2025

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË INSPEKTIMIT TË AGJENCISË SË
INDUSTRISË SË MBROJTJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 31, të ligjit nr. 87/2024, “Për rregullimin e prodhimit, tregtimit, kërkimit dhe zhvillimit të armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore së inspektimit të Agjencisë së Industrisë së Mbrojtjes, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

RREGULLORE
E INSPEKTIMIT TË AGJENCISË SË INDUSTRISË SË MBROJTJES

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i përmbajtjes, metodave, vendit, procedurave dhe standardeve të inspektimit, që do të zbatohen nga Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes gjatë kryerjes së inspektimeve për të verifikuar përputhshmërinë e veprimtarisë së tyre me legjislacionin në fuqi, aktet nënligjore, standardet e sigurisë teknike dhe mbrojtjes së mjedisit.

Neni 2
Qëllimi

Kjo rregullore përcakton përmbajtjen, metodat, vendin, procedurat dhe standardet e inspektimit, që do të zbatohen nga Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes, me qëllim sigurimin e një procesi të rregullt, transparent dhe profesional inspektimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 3
Standardet e inspektimit

1. Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes, gjatë kryerjes së inspektimit, zbaton standarde të përgjithshme të inspektimit, në funksion të mbrojtjes së interesit publik dhe forcimit të kontrollit institucional, nëpërmjet:

- a) planifikimit dhe realizimit të inspektimeve;
 - b) mbledhjes dhe analizimit të të dhënave;
 - c) përcaktimit të të drejtave dhe detyrave të trupës së inspektimit;
 - ç) procedurave, formave të inspektimit dhe të monitorimit të subjekteve të licencuara;
 - d) zbatimit të standardeve të sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit;
 - dh) rritjes së bashkëpunimit ndërinstitucional dhe shkëmbimit të informacionit;
 - e) trajnimit të vazhdueshëm të trupës së inspektimit dhe përditësimit të praktikave, në përputhje me zhvillimet teknologjike e legjislative;
 - ë) zbatimit të sanksioneve dhe kontrolleve të brendshme, kur është e nevojshme.
2. Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes, gjatë inspektimit, mbështetet në parimet e ligjshmërisë, proporcionalitetit, objektivitetit, transparencës dhe mbrojtjes së të dhënave.

KREU II

OBJEKTI, PËRMBAJTJA, METODA, VENDI DHE PROCEDURA E INSPEKTIMIT

Neni 4

Objekti i inspektimit

Objekti i inspektimit që kryen Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes (në vijim “Agjencia”) është kontrolli i përputhshmërisë me legjislacionin, rregulloret dhe me standardet e sigurisë e të mjedisit.

Neni 5

Llojet e inspektimeve

Inspektimet e kryera nga Agjencia klasifikohen në këto kategori:

- a) Inspektime periodike, të cilat janë të planifikuara në bazë të një kalendar vjetor, me qëllim monitorimin e vazhdueshëm të përputhshmërisë së subjekteve të licencuara me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi;
- b) Inspektime të jashtëzakonshme, të cilat janë inspektime të panjoftuara më parë, që realizohen për shkak të raportimeve, ankesave ose dyshimeve të arsyeshme mbi shkelje të mundshme të legjislacionit në fuqi, apo për shkak të situatave të papritura, që kërkojnë verifikim të menjëhershëm;
- c) Inspektime tematike, të cilat janë inspektime të fokusuara në fusha specifike të veprimtarisë, si: teknologjia, siguria e informacionit, pajisjet ushtarake, mbrojtja e mjedisit apo fusha të tjera, që identifikohe si prioritare, nëpërmjet analizës së rrezikut apo politikave strategjike të Agjencisë.

Neni 6

Organizimi i inspektimit

1. Inspektimet realizohen nga Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes, në përputhje me fushëveprimin e saj ligjor, aktet nënligjore dhe kompetencat e përcaktuara në këtë rregullore.

2. Inspektimi kryhet nga njësia organizative përgjegjëse për inspektimin, pasi është miratuar autorizimi nga drejtori i përgjithshëm i Agjencisë së Industrisë së Mbrojtjes, bazuar në planin përkatës së inspektimit.

3. Njoftimi i inspektimit përmban objektin, bazën ligjore, vendin e inspektimit, emrat e anëtarëve të trupës së inspektimit dhe kohën e inspektimit.

Neni 7

Plani i inspektimit dhe faza e zbatimit

1. Me qëllim garantimin e cilësisë, transparencës dhe përputhshmërisë së veprimtarive me standardet teknike, rregulloret përkatëse dhe dokumentacionin e miratuar, njësia organizative përgjegjëse për inspektimin pranë Agjencisë së Industrisë së Mbrojtjes harton dhe zbaton një plan të detajuar të inspektimit për subjekt, që i nënshtrohet mbikëqyrjes nga Agjencia, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Plani i inspektimit përfshin fazat e mëposhtme:

a) Inspektimi gjatë zhvillimit të punimeve, në përputhje me licencën paraprake për zhvillimin e veprimtarisë së prodhimit.

Qëllimi i kësaj faze është të verifikohet përputhshmëria e dokumentacionit me legjislacionin në fuqi.

Veprimtaritë përfshijnë:

i. kontrollin e dokumentacionit teknik, përfshirë projektet, lejet, planet e sigurisë dhe planin e mbrojtjes së mjedisit;

ii. verifikimin në terren të kushteve dhe aksesit në zonën e zhvillimit;

iii. kontrollin e përputhshmërisë së furnizimeve dhe pajisjeve me specifikimet teknike;

iv. verifikimin e kualifikimeve, certifikimeve të stafit teknik dhe operatorëve të përfshirë.

b) Inspektimi, pas përfundimit të punimeve apo përfundimit të veprimtarisë, në përputhje me licencën paraprake për zhvillimin e veprimtarisë së prodhimit.

Qëllimi i kësaj faze është verifikimi i përputhshmërisë së rezultatit përfundimtar me projektin dhe kërkesat ligjore, përpara finalizimit të fazës operacionale.

Veprimtaritë përfshijnë:

i. kontrollin e produktit final e përputhshmërinë me projektin dhe specifikimet teknike;

ii. testimet funksionale të instalimeve dhe të sistemeve të integruara;

iii. verifikimin e dokumentacionit të përfundimit, përfshirë certifikatat dhe manualët teknike;

iv. hartimin e raportit përfundimtar të inspektimit dhe paraqitjen e tij pranë autoritetit përgjegjës;

v. dhënien e rekomandimeve për mirëmbajtje, masa korrigjuese ose masa mbrojtëse afatgjata.

c) Inspektimi i përgjithshëm i subjektit të licencuar, gjatë dhe pas ushtrimit të veprimtarisë, përfshin vlerësimin gjithëpërfshirës të kapaciteteve, dokumentacionit e të përputhshmërisë së subjektit në të gjitha fazat e ciklit të licencimit dhe funksionimit.

Qëllimi i kësaj faze është inspektimi periodik ose i jashtëzakonshëm i aktivitetit të subjekteve të licencuara, për të siguruar përputhshmëri të vazhdueshme me licencën, standardet teknike, kushtet e sigurisë e detyrimet ligjore.

Veprimtaritë përfshijnë:

i. kontrollin e respektimit të kushteve të licencës dhe autorizimeve aktive;

- ii. verifikimin e procedurave të brendshme operative dhe zbatimin e praktikave të kontrollit të cilësisë;
 - iii. inspektimin e kushteve të sigurisë teknike, të ruajtjes dhe të transportit të produkteve ushtarake;
 - iv. verifikimin e funksionimit të sistemit të gjurmueshmërisë dhe markimit;
 - v. vlerësimin e trajtimit të incidenteve, reklamimeve apo raportimeve të brendshme;
 - vi. monitorimin e përditshëm të përputhshmërisë me kërkesat ligjore dhe standardet e aplikueshme të NATO-s, kur është rasti;
 - vii. verifikimin e kushteve të magazinimit.
3. Plani i inspektimit miratohet nga drejtori i përgjithshëm i Agjencisë së Industrisë së Mbrojtjes.

Neni 8

Metodat e inspektimit

1. Inspektimi, në kuadër të veprimtarisë së Agjencisë, realizohet nëpërmjet metodave të përcaktuara, që synojnë të garantojnë një vlerësim të gjithanshëm dhe objektiv të përputhshmërisë me kërkesat ligjore, teknike e të sigurisë.
2. Metodat kryesore të inspektimit përfshijnë:
 - a) inspektimin vizual, i cili konsiston në vëzhgimin e drejtpërdrejtë të pajisjeve, ambienteve apo të proceseve, me qëllim identifikimin e mospërputhjeve të dukshme ose rreziqeve të mundshme për sigurinë, funksionalitetin dhe përputhshmërinë teknike;
 - b) kontrollin teknik, nëpërmjet përdorimit të pajisjeve matëse dhe mjeteve të specializuara për të verifikuar parametrat funksionalë, cilësinë e zbatimit dhe përputhjen e komponentëve me standardet teknike përkatëse;
 - c) shqyrtimin dokumentar dhe intervistimin, që përfshijnë analizën e dokumentacionit teknik, raporteve të sigurisë, certifikatave të pajisjeve dhe të dhënave operative, si dhe zhvillimin e intervistave me personel përgjegjës apo teknik, me qëllim mbledhjen e informacionit të nevojshëm për procesin inspektues.
3. Nëse e kërkon natyra e objektit të inspektimit, Agjencia mund të përdorë edhe metoda të tjera shtesë, përfshirë testime funksionale ose simulime teknike, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet ndërkombëtare të aplikueshme.

Neni 9

Vendi i inspektimit

Vendi i inspektimit është vendi ku kryen veprimtarinë e tij subjekti i inspektimit.

Neni 10

Procedurat e inspektimit

1. Inspektimi zhvillohet në përputhje me parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe objektivitetit, me synim garantimin e përputhshmërisë së subjekteve të licencuara me kërkesat ligjore e standardet teknike të sigurisë, cilësisë dhe mbrojtjes së mjedisit.
2. Procedurat e inspektimit përfshijnë fazat e mëposhtme:

a) Agjencia harton planin përkatës të inspektimit, në të cilin përcaktohen objekti e qëllimi i inspektimit, standardet teknike të zbatueshme, si dhe lloji e natyra e inspektimit;

b) Në rastet e inspektimeve të planifikuara, subjekti i licencuar njoftohet me shkrim, të paktën 5 ditë kalendarike përpara datës së inspektimit, dhe njoftimi përmban qëllimin e inspektimit, fushën e kontrollit, datën, vendin, emrat e anëtarëve të trupës së inspektimit, kohëzgjatjen e tij.

3. Subjekti i inspektuar është i detyruar të vërë në dispozicion dokumentacionin që lidhet me objektin e inspektimit, duke përfshirë licencat dhe autorizimet përkatëse, certifikatat teknike, raportet e mëparshme të inspektimit, manualët e funksionimit të pajisjeve, të dhënat për masat e sigurisë e të mbrojtjes së mjedisit, si dhe çdo dokument tjetër të kërkuar në njoftimin përkatës ose gjatë zhvillimit të procesit të inspektimit.

4. Trupa e inspektimit realizon në vend verifikimin e dokumentacionit e të kushteve faktike të pajisjeve, sistemeve dhe proceseve teknike, kontrollin fizik të objekteve, përfshirë matje teknike, testime apo marrje mostrash për analizë, vlerësimin e kushteve të punës e të masave të sigurisë në ambientet përkatëse, intervistimin e personelit teknik e drejtues, si dhe kryerjen e vëzhgimeve e të regjistrimeve, në përputhje me rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të informacionit të ndjeshëm.

5. Pas përfundimit të inspektimit kryhet analiza e gjetjeve e krahasimi i tyre me standardet teknike të zbatueshme, si dhe vlerësimi i funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm e të menaxhimit të cilësisë.

6. Trupa e inspektimit harton raportin përfundimtar të inspektimit, i cili përmban gjetjet kryesore dhe konstatimet faktike, rekomandimet për përmirësim e masat korrigjuese të propozuara, afatet për zbatimin e tyre, si edhe të drejtën e subjektit për të paraqitur ankesë ose shpjegim me shkrim.

7. Pas përfundimit të afateve të përcaktuara për zbatimin e masave, Agjencia kryen një inspektim verifikues dhe, në rast të moszbatimit të masave, të ndërmarrë masa administrative ose masa të tjera të parashikuara në kuadrin rregullator përkatës.

KREU III

RAPORTET E INSPEKTIMIT DHE MASAT PAS INSPEKTIMIT

Neni 11

Hartimi i raporteve të inspektimit

1. Pas përfundimit të çdo inspektimi, trupa e inspektimit është përgjegjëse për përgatitjen e një **procesverbali**, i cili dokumenton në mënyrë të detajuar dhe kronologjike të gjitha veprimet e kryera gjatë inspektimit, përfshirë datat, vendndodhjet, personat e kontaktuar e çdo veprim tjetër të rëndësishëm.

2. Brenda një afati prej **15 ditësh punë** nga përfundimi i inspektimit, trupa e inspektimit harton një **raport paraprak**, i cili përmban:

a) objektin e inspektimit, datën dhe vendndodhjen, ku është kryer inspektimi;

b) përshkrimin e veprimtarive të verifikuara, metodologjinë e ndjekur dhe periudhën kohore të kontrollit;

c) gjetjet konkrete të konstatuara të lidhura me referencat ligjore dhe rregulloret përkatëse, që janë zbatuar ose janë shkelur;

ç) provat mbështetëse, që dokumentojnë gjetjet, përfshirë fotografi, dokumente të skanuara, transkriptet e intervistash, analiza laboratorike ose të dhëna të tjera të verifikueshme;

d) vlerësimin e nivelit të përputhshmërisë së subjektit të inspektuar me kërkesat ligjore dhe standardet e aplikueshme;

dh) rekomandimet për masa korrigjuese, përmirësuese ose administrative, bashkë me afatet për zbatimin e tyre;

e) në rastet e shkeljeve të rënda, rekomandimin për pezullim aktiviteti, pezullim licence ose ndërhyrje të tjera administrative.

3. Raporti paraprak i dërgohet subjektit të inspektuar dhe palëve të interesuara, të cilët kanë të drejtë të paraqesin **observacionet e tyre me shkrim, brenda 5 ditëve punë** nga data e marrjes së raportit.

4. Pas shqyrtimit të observacioneve, brenda një afati prej 15 ditësh pune, trupa e inspektimit harton **raportin përfundimtar të inspektimit**, i cili i paraqitet për miratim drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë së Industrisë së Mbrojtjes. Një kopje e raportit përfundimtar i dorëzohet subjektit të inspektuar, i cili ka të drejtë të paraqesë ankim pranë Komisionit të Ankimit Administrativ në Ministrinë e Mbrojtjes, brenda **30 ditëve kalendarike** nga data e marrjes dijeni për raportin.

5. Në raste të veçanta, kur përfundimi i raportit përfundimtar varet nga rezultatet e analizave laboratorike apo testimeve të tjera zyrtare, **afati i hartimit të raportit përfundimtar zgjatet me deri në 15 ditë punë** nga data e marrjes së përgjigjeve zyrtare të këtyre testeve.

6. Në rastet kur konstatohet një shkelje e rëndë ose një rrezik i menjëhershëm për sigurinë, raporti përfundimtar shoqërohet me propozime për masa urgjente.

7. Trupa e inspektimit mban përgjegjësi për saktësinë, paanshmërinë dhe përmbajtjen e procesverbalit e të raportit të inspektimit.

Neni 12

Arkivimi dhe shpërndarja e raporteve të inspektimit

1. Raportet e inspektimit ruhen nga njësia organizative përgjegjëse për sekretarinë dhe arkivin pranë Agjencisë së Industrisë së Mbrojtjes, në përputhje me rregullat për administrimin, sigurinë dhe aksesin ndaj dokumentacionit zyrtar.

2. Raportet e inspektimit mund të shpërndahen ose të vihen në dispozicion të institucioneve të tjera shtetërore, në varësi të natyrës së gjetjeve dhe nevojës për veprime të mëtejshme, si më poshtë vijon:

a) Ministrisë së Mbrojtjes, për qëllime të koordinimit institucional, ndjekjes administrative dhe politike në fushën e mbrojtjes;

b) Strukturave të tjera mbikëqyrëse apo rregullatore, në rastet kur evidentohen shkelje të rënda, mospërputhje me legjislacionin ose rreziqe për sigurinë dhe mjedisin;

c) Organeve të drejtësisë, nëse gjatë inspektimit konstatohet se janë kryer veprime ose mosveprime, që përbëjnë elemente të veprës penale ose janë objekt hetimi ligjor.

3. Shpërndarja dhe përdorimi i raporteve të inspektimit kryhet në përputhje me parimet e konfidencialitetit e duke respektuar legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale e të informacioneve të klasifikuara.

Neni 13

Masat pas inspektimit

1. Pas finalizimit të raportit të inspektimit e të dorëzimit të tij pranë subjektit të inspektuar, Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes merr masat përkatëse në përputhje me natyrën dhe rëndësinë e gjetjeve të konstatuara gjatë procesit të inspektimit.

2. Në rast konstatimi të shkeljeve apo të mospërputhshmërive, Agjencia miraton urdhër për ndërmarrjen e masave korrigjuese, duke përcaktuar një afat të arsyeshëm për zbatimin e tyre, në varësi të natyrës së shkeljes, nivelit të rrezikut dhe kompleksitetit të ndërhyrjeve të nevojshme.

KREU IV PËRBËRJA E TRUPËS SË INSPEKTIMIT

Neni 14

Përbërja e trupës së inspektimit

1. Trupa e inspektimit përbëhet nga inspektorë dhe ekspertë të Agjencisë së Industrisë së Mbrojtjes.

2. Numri i anëtarëve të trupës së inspektimit nuk mund të jetë më pak se tre.

3. Në varësi të natyrës dhe të kompleksitetit të inspektimit, në përbërje të trupës së inspektimit mund të përfshihen:

a) me kërkesë të drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë, përfaqësues të Ministrisë së Mbrojtjes ose të institucioneve të tjera shtetërore, sipas fushës së tyre të ekspertizës;

b) ekspertë ose specialistë të jashtëm me njohuri të veçanta teknike, me kërkesë të strukturës përgjegjëse për inspektim në Agjencinë e Industrisë së Mbrojtjes dhe me miratim të drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizimin e funksionimin e Agjencisë së Industrisë së Mbrojtjes.

Neni 15

Të drejtat dhe detyrat e inspektorëve

Inspektorët e trupës së inspektimit, gjatë ushtrimit të detyrës, kanë këto të drejta dhe detyrime:

a) Kanë akses të plotë, të lirë e të menjëhershëm në ambientet, pajisjet, instalimet, infrastrukturën dhe dokumentacionin e subjekteve të licencuara, gjatë orarit zyrtar të punës dhe në raste të justifikuara edhe jashtë tij;

b) Kërkojnë, marrin e shqyrtojnë çdo dokumentacion teknik, ligjor, financiar apo administrativ të nevojshëm për inspektimin, përfshirë të dhënat fizike dhe elektronike, si: regjistrat, kontratat, lejet, licencat apo informacionin e përpunuar nga pajisje mbështetëse;

c) Konstatojnë e dokumentojnë çdo shkelje apo mospërputhje me kërkesat ligjore dhe në rastet kur evidentohen rreziqe për sigurinë kombëtare, mbrojtjen e mjedisit, shëndetin publik apo funksionimin e infrastrukturës kritike, propozojnë ose marrin masa të përkohshme parandaluese apo ndaluese, sipas kompetencës ligjore;

ç) Përgatisin raporte inspektimi me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse, të cilat i paraqiten drejtorit të përgjithshëm për vendimmarrje të mëtejshme administrative.

KREU V TRAJNIMET

Neni 16

Qëllimi i trajnimeve

1. Trajnimet për inspektorët e Agjencisë së Industrisë së Mbrojtjes synojnë forcimin e kapaciteteve profesionale, për të garantuar një proces inspektimi efektiv e të përputhshëm me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.

2. Qëllimet kryesore të trajnimeve janë:

- a) rritja e kapaciteteve teknike dhe ligjore të stafit inspektues;
- b) sigurimi i përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare të cilësisë dhe të sigurisë;
- c) përmirësimi i aftësive për identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve në mjedise me ndjeshmëri të lartë për sigurinë kombëtare, apo për teknologjinë.

Neni 17

Formatet dhe përmbajtja e trajnimeve

1. Programet e trajnimit realizohen në forma të ndryshme, në përputhje me nivelin e eksperiencës së stafit dhe nevojat e veçanta të detyrës, duke përfshirë:

- a) trajnime bazë për inspektorë të rinj;
- b) trajnime të avancuara teknike;
- c) pjesëmarrje në seminare ndërkombëtare dhe shkëmbim përvojash.

2. Programi vjetor i trajnimeve miratohet nga drejtori i përgjithshëm i Agjencisë së Industrisë së Mbrojtjes e përshtatet në vijimësi, sipas nevojave institucionale dhe të zhvillimeve teknologjike apo ligjore në fushën e industrisë së mbrojtjes.

KREU VI

MASAT ADMINISTRATIVE PËR SHKELJET DHE PROCEDURA E ANKIMIMIT

Neni 18

Sanksionet dhe përgjegjësia për shkeljet

1. Mospërbushja e detyrimeve të parashikuara në këtë rregullore, nëpërmjet pengimit, vonesës apo fshehjes së informacionit të kërkuar nga struktura përgjegjëse për inspektimin, përbën shkelje dhe sjell përgjegjësi administrative ose disiplinore, në varësi të rrethanave dhe ashpërsisë së veprimit.

2. Kur gjatë inspektimit evidentohen shkelje të rënda ose të përsëritura, Agjencia harton një raport të posaçëm dhe rekomandon:

- a) marrjen e masave administrative ndaj subjektit, përfshirë pezullimin ose revokimin e licencës;
- b) marrjen e masave disiplinore ndaj punonjësve përgjegjës nëpërmjet njoftimit të strukturës kompetente të punëdhënësit;
- c) paraqitjen e kallëzimit penal, nëse konstatohen elemente të një vepre penale, sipas legjislacionit penal në fuqi.

3. Në rastet kur konstatohet përputhje e pjesshme me kërkesat ligjore ose mangësi në zbatim, Agjencia mund të kërkojë hartimin e një plani veprimi për përmirësim me masa konkrete dhe afate të përcaktuara për zbatimin e tij.